



**URDHËR**

Nr. 5285 Datë 1.6.2017

**PËR**

**PRISHJEN E SHOQËRISË "KËPUCA" SH.A, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të Ligjit Nr. 8885, datë 22.4.2002, për disa ndryshime në Ligjin Nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Këpuca" sh.a Korçë,

**URDHËROJ:**

1. Prishjen e shoqërisë "Këpuca" Korçë dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Z. Ilia Jatagani, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
4. Znj. Ludmilla Paluka, Ekspert Kontabël i Autorizuar, të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





nr 102 prot  
dh 31.8.2017

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,  
TURIZMIT, TREGTISE DHE SIPERMARRJES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONES  
SHTETËRORE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_. \_\_. 2017

URDHËR

Nr. 7084, datë 30.8.2017

PËR  
SISTEMIMIN E VEPRIMEVE NË KONTABILITET DHE  
HARTIMIN E BILANCIT TË MBYLLJES TË SHOQËRISË  
"KËPUCA" KORÇË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Këpuca" sh.a Korçë:

URDHËROJ

1. Asetet e shoqërisë, llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme, sipas bilancit fillestar të likuidimit, të miratuar me urdhrin e MZHETTS Nr. 6304/1, datë 14.8.2017 "Për miratimin e bilancit fillestar të shoqërisë "Këpuca" Korçë dhe depozitimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit", ti kalojnë shoqërisë "Petrolalba" shoqëri në likuidim e sipër.
2. Llogaritë pa shpresë arkëtimi dhe detyrimet e pakërkueshme të sistemohen me rezultatim.
3. Ekspertja Kontabël e Autorizuar Znj. Ludmilla Paluka, të përgatisë raportin për sistemimin e llogarive dhe përpilimin e bilancit përfundimtar të mbylljes.
4. Ngarkohet Likuidatori i shoqërisë "Këpuca" sh.a Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", +355 4 224 0098, ekonomia.gov.al, zmd@ekonomia.gov.al

nr 100 prot  
dh 18.8.2017



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISE DHE SIPERMARRJES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONES SHTETËRORE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

URDHËR

Nr. 6304/1, datë 14.8.2017

PËR

MIRATIMIN E BILANCIT FILLESTAR TË SHOQËRISË "KËPUCA" SHA KORÇË  
DHE DEPOZITIMIN NË QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT.

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Këpuca" Korçë:

URDHËROJ:

1. Miratimin e bilancit fillestar të likuidimit dhe raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar.
2. Likuidatori i shoqërisë të marrë masa për mbylljen e veprimeve të shoqërisë, arkëtimin e debitorëve, shitjen e aseteve dhe shlyerjen e kreditorëve, duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
3. Pas përfundimit, të njoftohet Qendra Kombëtare e Biznesit, për përfundimin e likuidimit dhe të kërkohet çregjistrimi i shoqërisë, në përputhje me seksionin V të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për Regjistrimin e Biznesit".
4. Ngarkohet Drejtorja e shoqërisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, http://ekonomia.gov.al

**RAPORT**

**PER ÇERTIFIKIMIN**

**E BILANCIT TE LIKUIDIMIT**

**TE SHOQERISE KEPUCA sha KORCE**

**ME 31.05.2017**

EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

---

**PERMBAJTJA**

- Raporti i ekspertës kontabel te regjistruar
  - Bilanci i likuidimit me 31.05.2017
-

**RAPORT PER ÇERTIFIKIMIN E BILANCIT TE LIKUIDIMIT  
TE KEPUCA SHA KORCE ME 31.05.2017**

**Drejtuar: Zj.Milva EKONOMI, Ministre e MZHETTS,  
Ne perfaqesine e Aksionerit te vetem te shoqerise,**

**Z.Ilia Jatagani, Likuidator i Shoqerise SHA Kepuca Korce,**

Ne kryerjen te misionit qe me eshte besuar prej jush , kam nderin t`ju paraqes raportin mbi çertifikimin e Bilancit ne momentin e shpalljes se likuidimit me 01.06.2017

- **Baza ligjore e ketij procesi:** Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligji 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",
- Urdheri MZHETTS Nr 5285, date 01.06.2017 per çertifikimin e Bilancit te Likuidimit
- Pasqyrat Financiare te dates 31.05.2017 si dhe dokumenta ligjore e kontabile te vena ne dispozicion nga te dy shoqerite.

**Cregjistrimi i Shoqerise**

Bazuar ne Ligjin 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" jane percaktuar procedurat per realizimin e ketij procesi, dhe Neni 198 i ketij te fundit percakton.

*Bilancet*

*Likuiduesi pergatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.*

**Misioni i çertifikimit te Bilancit te likuidimit**

Aksioneri i vetem i Shoqerise **Kepuca sha** Korce ka urdheruar te certifikohet Bilanci i likuidimit. Ne zbatim te tij Likuidatori i Shoqerise ka pergatitur Bilancin ne momentin e shpalljes se likuidimit me date 31.05.2017.

Misioni yne eshte te japim nje pasqyre analitike te te drejtave dhe detyrimeve te Bilancit te Shoqerise ne momentin e shpalljes se likuidimit.

**Pasqyrat Fianciare ne momentin e shpalljes se likuidimit jane si me poshte:**



## EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

Nr	A K T I V E T	Shenime	31.05.2017	Viti 2,016
I	<b>A K T I V E T A F A T S H K U R T R A</b>		<b>13,397,708</b>	<b>14,399,110</b>
1	<b>Aktivete monetare</b>		<b>165,608</b>	<b>1,167,010</b>
	> Banka		108,315	1,151,927
	> Arka		57,293	15,083
2	<b>Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim</b>			
3	<b>Aktive te tjera financiare afatshkurtra</b>		<b>4,613,959</b>	<b>4,613,959</b>
	> Kliente per mallra,produkte e sherbime		2,781,880	2,781,880
	> Debitore, Kreditore te tjere		1,456,780	1,456,780
	> Tatim mbi fitimin			
	> Tvsh		10,000	10,000
	> Te drejta e detyrime te ortakeve		365,299	365,299
4	<b>Inventari</b>		<b>8,618,141</b>	<b>8,618,141</b>
	> Lendet e para		8,618,141	8,618,141
5	<b>Aktive biologjike afatshkurtra</b>			
6	<b>Aktive afatshkurtra te mbajtura per rishitje</b>			
7	<b>Parapagime dhe shpenzime te shtyra</b>			
	> Shpenzime te periudhave te ardhshme			
	<b>TOTAL I AKTIVEVE AFAT SHKURTERA (I)</b>		<b>13,397,708</b>	<b>14,399,110</b>
II	<b>A K T I V E T A F A T G J A T A</b>			
1	<b>Investimet financiare afatgjata</b>			
2	<b>Aktive afatgjata materiale</b>			
	> Toka		70,305,542	70,305,542
	> Ndertesa		30,156,832	30,694,756
	> Makineri dhe paisje			
	> Makineri per tu shitur (Mbeturina)		869,399	948,435
3	<b>Aktive biologjike afatgjata</b>			
4	<b>Aktive afatgjata jo materiale</b>			
5	<b>Kapitali aksioner i pa paguar</b>			
6	<b>Aktive te tjera afatgjata</b>			
	<b>TOTAL I AKTIVEVE AFAT AFATGJATA (II)</b>		<b>101,331,773</b>	<b>101,948,733</b>
	<b>TOTALI AKTIVEVE (I+II)</b>		<b>114,627,481</b>	<b>116,347,843</b>



## EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

Nr	PASIVET DHE KAPITALI	31.05.2017	Viti 2,016
<b>I</b>	<b>PASIVET AFATSHKURTRA</b>	<b>6,274,766</b>	<b>5,194,538</b>
1	Derivativet		0
2	Huamarjet		0
3	Huat dhe parapagimet	<b>6,274,766</b>	<b>5,194,538</b>
	> Te pagueshme ndaj furnitoreve		0
	> Te pagueshme ndaj punonjesve	264,175	135,580
	> Detyrime per Sigurime Shoq. Shend.	3,533,711	3,490,528
	> Detyrime tatimore per TAP-in	75,250	14,300
	> Detyrime tatimore per Tatim Fitimin		0
	> Detyrime per Gjoha e penalitete (gjyqi)	100,000	
	> Detyrime tatimore per Tatimin ne Burim	187,883	145,883
	> Te drejta e detyrime ndaj eksperteve	408,000	0
	> Debitore dhe Kreditore te tjere	958,015	958,015
	> Debitore dhe Kreditore te tjere (K. Mbikqyres)	747,732	450,232
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra		0
5	Provizionet afatshkurtra		0
<b>II</b>	<b>PASIVET AFATGJATA</b>	<b>19,686,443</b>	<b>19,686,443</b>
1	Huat afatgjata		
2	Huamarje te tjera afatgjata	19,686,443	19,686,443
3	Grantet dhe te ardhurat e shtyra		0
4	Provizionet afatgjata		0
	<b>TOTALI PASIVEVE (I+II)</b>	<b>25,961,209</b>	<b>24,880,981</b>
<b>III</b>	<b>KAPITALI</b>	<b>88,768,272</b>	<b>91,466,862</b>
1	Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)		
2	Kapitali aksionereve te shoq. meme (PF te kons.)		0
3	Kapitali aksionar	46,903,320	46,903,320
4	Rezerva e rivleresimit te tokes	57,720,728	57,720,728
5	Njesite ose aksionet e thesarit (Negative)		
6	Rezervat statutore	1,975,579	1,975,579
7	Rezervat ligjore	3,210,143	3,210,143
8	Rezervat e tjera	158,869	158,869
9	Fitimet e pa shperndara (humbje te viteve kaluara)	-18,501,777	-18,247,910
10	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	-2,698,590	-253,867
	<b>TOTALI PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)</b>	<b>114,627,932</b>	<b>116,347,843</b>



**Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve sipas natyres**

	Pershkrimi i Elementeve	Viti 31.05.2017	Viti 2016
1	Te ardhura nga Financimet gjithsej	300,000	4,999,100
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria kontabilizimi V.Rojes	101,550	0
4	Materialet e konsumuara		0
5	Kosto e punes	- 1,592,855	3,295,680
	<i>Pagat e personelit +K/Mbikqyres</i>	- 1,415,000	2,760,000
	<i>Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore</i>	- 177,855	535,680
6	Amortizimet dhe zhvleresimet	- 818,510	1,288,529
7	Shpenzime te tjera	- 687,790	671,183
8	<b>Totali shpenzimeve ( shumat 4 - 7 )</b>	<b>- 3,099,155</b>	<b>- 5,255,392</b>
9	<b>Fitimi (humbja) nga veprimtarite e kryesore (1+2+/-3-8)</b>	<b>- 2,697,605</b>	<b>(256,292)</b>
10	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara		
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet		
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare ( Komisione)		2,425
	121 <i>Te ardh.e shpenz. financ.nga inves.te tjera financ.afetgjata</i>		
	122 <i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat</i>	- 985	2,425
13	<b>Totali i te Ardhurave dhe Shpenzimeve financiare</b>		0
14	<b>Fitimi (humbja) para tatimit ( 9 +/- 13 )</b>	<b>- 2,698,590</b>	<b>- 253,867</b>
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		0
16	<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar ( 14 - 15 )</b>	<b>- 2,698,590</b>	<b>(-253867)</b>
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara		





## EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

Nr	Pasqyra e fluksit monetar – Metoda direkte 31.05.2017	
	31.05.2017	2016
<b>A</b>	<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	
	Mjetet monetare (MM) të arkëtuara nga klientët	
	MM të paguara ndaj furnitorëve dhe punonjësve	- 1,302,313 - 4,855,135
	MM të ardhura nga Financimet	300,000 4,999,100
	Interesi i paguar Komisione)	910 - 6,388
	Tatim mbi fitimin i paguar	
	<b>MM neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>- 1,001,403 137,577</b>
<b>B</b>	<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</b>	
	Blerja e njësisë së kontrolluar X minus paratë e Arkëtuara	
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	
	Të ardhurat nga shitja e pajisjeve	
	Interesi i arkëtuar	2,425
	Dividendët e arkëtuar	
	<b>MM neto të përdorura në veprimtaritë investuese</b>	
<b>C</b>	<b>Fluksi monetar nga aktivitetet financiare</b>	
	Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	
	Të ardhura nga huamarrje afatgjata	
	Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare	
	Dividendë të paguar	
	<b>MM neto e përdorur në veprimtaritë financiare</b>	
<b>D</b>	<b>Rritja neto e mjeteve monetare</b>	<b>- 1,001,402 135,152</b>
<b>E</b>	<b>Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël</b>	<b>1,167,010 1,031,858</b>
<b>F</b>	<b>Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël</b>	<b>165,608 1,167,010</b>

## EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

Pasqyra e Levizjeve te Kapitalit

	Kapitali aksionar	Rez. rivl. tokes	Rezerva stat. ligjore	Fitimi pashperndare	TOTALI
1 Pozicioni I me 31/12/2014		0			
1 Fitimi neto per periudhen kontabel 2015(humbje)					
2 Fitime te trasheguara nga 2014					
3 Rritja rezerves kapitalit					
4 Kapitali aksionar	0				
1 Pozicioni me 31 /12/ 2015	46,903,320	57,720,728	5,344,591	-18,247,910	91,720,729
1 Fitimi neto per periudhen kontabel 2016(humbje)				-253,867	-253,867
2 Fitime te trasheguara nga 2015					
3 Rritja rezerves kapitalit					
4 Kapitali aksionar	0				
1 Pozicioni me 31 dhjetor 2016	46,903,320	57,720,728	5,344,591	-18,501,777	91,466,862
1 Fitimi neto per periudhen kontabel 31.05.2017				-2,698,590	-2,698,590
2 Fitime te trasheguara nga 2016					
3 Rritja rezerves kapitalit					0
4 Kapitali aksionar	0				0
1 Pozicioni me 31 Maj 2017	46,903,320	57,720,728	5,344,591	-21,200,367	88,768,272

**Analize e Aktiveve dhe Pasiveve te Shoqerise Kepuca Korce - Shoqeri ne Likuidim**

Bejme me dije se Pasqyrat Fianciare te Shoqerise SHA Kepuca Korce me 31.12.2016, jane audituar dhe miratuar ne Aksioneri i vetem i saj.

**1. Grupi i aktiveve monetare eshte pasqyruar si me poshte:**

Aktive Monetare	31.05.2017	31.12.2016	Ndryshimi +/-
Para ne Banka	108,315.00	1,151,927.00	(1,043,612.00)
Vlera arke	57,293.00	15,083.00	42,210.00
			0.00
<b>Totali</b>	<b>165,608.00</b>	<b>1,167,010.00</b>	<b>(1,001,402.00)</b>

Shoqeria ne date 31.05.2017 disponon gjendjen e mesiperme te aktiveve monetare, kjo e vertetuar me veprimet bankare dhe te arkes te kesaj periudhe aktiviteti 5 mujor.

Sipas ekstraktit bankar gjendja prane Bankes Raiffeisen me 31.05.2017 eshte 108.315 leke, dhe sipas proces verbalit te arkes gjendja e saj eshte 57.293 leke.

**2. Grupi i aktiveve te tjera financiare afatshkurtera eshte pasqyruara si me poshte:**

Aktive Afatshkurtra	31.05.2017	31.12.2016	Ndryshimi +/-
Kliente per mallra	2,781,880.00	2,781,880.00	0.00
Debitore te tjere	1,456,780.00	1,456,780.00	0.00
Tvsh	42,000.00	10,000.00	32,000.00
Te drejta e detyrime te ortakeve	365,299.00	365,299.00	0.00
<b>Totali</b>	<b>4,645,959.00</b>	<b>4,613,959.00</b>	<b>0.00</b>

- Shoqeria SHA Kepuca Korce prej mese 10 vjetesh, pra ne Bilancin e vitit 2006-2007 paraqet te njejten gjendje klientesh per arketim prej 2.781.880 leke. Ne keto Balance ky ze eshte i pa analizuar per shumen prej 681.880 leke dhe per vleren prej 2.100.000 leke shpjegohet se i takon Shoqerise "Nordit AL" me te cilen eshte hapur nje proces gjyqesor por nuk ka asnje informacion per cfare eshte vendosur.

Kerkimi jone prane QKB rezulton se ky emer nuk figuron prane kesaj qendre. Ne keto kushte ne sugjerojme Likuidatorin qe pas Njofimitit te Kreditoreve ne QKB, ne rast se nuk ka pretendime per kete shume te kryhen procedurat per kalimin ne humbje te kesaj vlere.

- Ne postin e bilancit "Debitore te tjere" prej 1.456.780 leke paraqiten dy shuma, njera prej 667.776 leke eshte mbi 10 vjet, e cila ne shpjegimet e bilancit te vitit 2007 eshte e paidentifikuar si e drejte. Ndersa shuma prej 789.014 leke eshte nje e drejte e pretenduar

per nje ceshtje gjyqesore te ngritur ndaj ish-Administratores se meparshme per vlera asetesh te munguara dhe vlera gjobash tatimore ndaj Shoqerise per pakujdesi ne administrim te Shoqerise si me poshte vijon:

Vlera neto e dy kabinave elektrike te munguara prej	422.000 leke
Vlera qe perfaqeson gjoba per pakujdesi ne raportim prej	365.334 leke
Vlera ne ngarkim sipas raportit audit te MEI prej	1.680 leke
<b>Total</b>	<b>789.014 leke</b>

Kjo ceshtje gjyqesore ne dy shkalle te zhvillimit te saj ka rezultuar te jete ne humbje te Shoqerise Kepuca Korce dhe si e tille sugjerohet te provizionohet si humbje. Gjithashtu Shoqeria ka krijuar nje fond provigjionimi per shpenzime gjyqesore prej 100.000 leke

- Posti i bilancit "Te drejta ndaj TVSH" prej 10.000 leke , eshte nje e drejte e cila nuk ekziston ne sistemin on-line te tatimeve te Shoqerise. Si e tille sugjerohet te kaloje ne humbje.
- Ne postin e bilancit "Te drejta ndaj ortakeve" me vlere prej 365.299 leke, perfaqeson nje te drejte te pidentifikuar, kjo sipas shpjegimeve te bilancit te vitit 2007.

### 3. Inventari ne date 31.05.2017 eshte i pasqyruar ne shumen leke

Iventaret	31.05.2017	31.12.2016	Ndryshimi +/-
Lende te para	8,618,141.00	8,618,141.00	-
Parapagesa per furnizime	0.00	0.00	-
<b>Totali</b>	<b>8,618,141.00</b>	<b>8,618,141.00</b>	<b>0.00</b>

Informojme se Shoqeria SHA Kepuca Korce, ne Bilancin e 31.12.2015 ka perthithur Shoqerine Trikotazhi Korce, dhe ne kete proces nje inventar me vlere prej 1.353.575 leke ka kaluar nen administrimin e saj. *Inventari analitik eshte pjese e dorezimit te dokumentacionit te Shoqerise SHA Trikotazhi Korce per SHA Kepuca Korce.*

Gjithashtu ajo ka pasur si inventar te saj para ketj procesi, qe prej Bilancit te transformimit te vitit 1998 nje inventar me nje vlere prej 7.264.566 me artkuj si me poshte vijon:

inventari	cmim	sasi	vlere
shoje burash	198	25,025	4,954,950
shoje grash	172	13,428	2,309,616
<b>Totali</b>			<b>7,264,566</b>

Bejme me dije se ky inventar eshte ne gjendje mjaft te demtuar dhe pothuaj jashte perdorimit. Shoqeria i eshte drejtuar Fabrikes se Prodhimit te Kepuceve MAS-TOR shpk Korce per blerjen e tyre, dhe pergjigja shkesore eshte qe keto shoje jane te paperdoreshme ne prodhim. Sugjerojme te kryhen procedurat perkatese per vlersimin e tyre dhe nxjerrjen jashte perdorimit referuar Udhezimin nr.30, date 27.12.2011" Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik".



**EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR**

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

**4. Aktivet afatgjata materiale paraqiten si vijon:**

Aktive Afatgjata	<u>31.05.2017</u>	<u>31.12.2016</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Toka	70,305,542.00	70,305,542.00	0.00
Ndertesa	30,055,281.92	30,694,756.00	(639,474.08)
Mbetje Makineri per shitje	869,398.75	948,435.00	(79,036.25)
<b>Totali</b>	<b><u>101,230,222.67</u></b>	<b><u>101,948,733.00</u></b>	<b><u>(718,510.33)</u></b>

**Po japim nje situate te aktiveve afatgjata ne momentin e perthithjes se Shoqerise SHA Trikotazhi Korce nga SHA Kepuca Korce me 31.12.2015:**

A K T I V E T	Kepuca Korce SHA 31.12.2015	Trikotazhi Korce SHA 31.12.2015	Trikotazhi Korce SHA 31.12.2015 pas urdherit MZHETTS	Shoqeria Kepuca Korce SHA 31.12.2015 pas bashkimit
> Toka	7,268,334	5,346,720	63,037,208	70,305,542
> Ndertesa	1,394,939	60,703,685	30,578,766	31,973,705
> Makineri dhe paisje	0	958,015		0
> Makineri per tu shitur(mbeturina)	0		958,015	958,015
<b>TOTAL I AKTIVEVE AFAT AFATGJATA (II)</b>	<b>8,663,273</b>	<b>67,008,420</b>	<b>94,573,989</b>	<b>103,237,262</b>

Per zcrin "Toka" situata e me 31.05.2017 e Shoqerise se bashkuar **SHA Kepuca Korce** eshte e pa ndryshuar, pra ky ze ne total paraqitet me nje vlere prej 70.305.542 leke dhe perfaqeson keto siperfaqe toke:

- Toke nen administrim te SHA Kepuca Korce, por e mare nga **SHA Trikotazhi Korce** me siperfaqe 7384 m2 dhe me nje vlere prej 63.037.208 leke ( kjo toke eshte rivleresuar ne vitin 2015 gjate procesit te bashkimit te Shoqerive me 8537 lek/m2).
- Toke nen administrim te SHA Kepuca Korce me nje vlere prej 7.268.334 leke (sipas dokumentacionit duhej te ishte 7.550.900 leke per nje siperfaqe prej 308,2 m2 vlersuar me nje cmim prej 24.500 leke/m2 (vlersimi eshte bere ne vitin 2009)
- Shoqeria Kepuca Korce, ne baze te kerkimeve ka edhe 16.5 m2 truall me nje Ndertese-Vend- Roje, nen emrin e Shoqerise **SHA Kepuca Korce**.

**Kjo prone nuk eshte e regjistruar ne Kontabilitet. Ne sugjuernam qe kjo ndertese te regjistrohet me cmimin per m2 te nderteses ekzistuese qe ajo ka ne pronesi, pra me nje vlere prej 16.5 m2 x 6154 = 101.550 leke**

Siperfaqia e truallit i eshte kthyer ish-pronarit nga Komisioni i Kthimit te Pronave. Sugjerohet qe Likuidatori i Shoqerise te kryeje procedurat perkatese per shitjen e kesaj Prone.

Duhet theksuar se **SHA Trikotazhi Korce**, qe prej krijimit te saj nuk ka regjistruar pasurite e saj prane ZRRP Korce.Likuidatori i Shoqerise se bashkuar eshte ne ndjekje te saktesimit dhe nxjerrjes se ketyre certifikatave.

**EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR**

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

Shoqeria ne momentin e likuidimit, me 31.05.2017 nuk zoteron asnje certifikate per truallin por ajo eshte ne ndjekje te sakesimit dhe marrjes se tyre me ZRPP Korce  
Per zerin "Ndertesa" detajet sips objekteve paraqiten si vijon:

<b>Aktive Afatgjata</b>	<b>31.05.2017</b>	<b>31.12.2016</b>	<b>31.12.2015</b>
Ndertesa K.Korce Kati 2	1,311,243	1,339,141	1,394,939
Ndertesa K.Korce V.Roje	101,550		
Ndertesa Trik.Korce Repart	23,061,718	23,552,393	24,533,743
Ndertesa Trik.Korce Magazin	5,682,322	5,803,222	6,045,023
<b>Totali</b>	<b>30,156,832</b>	<b>30,694,757</b>	<b>31,973,705</b>

Sipas Raportit te Vlersimit te vitit 2015 , godinat gjendje te SHA Trikotazhi Korce, me 31.12.2015 jane si me poshte:

<b>Ndertesat e Trikotazhit</b>	<b>sip.m2</b>	<b>VI.rivlersuar</b>
Objekti repart	3,840	24,533,743
Objekti magazine	546	6,045,023
<b>Total Ndertesat</b>		<b>30,578,766</b>

Objekti Ndertese - Kati i dyte i Kepuca Korce, perfaqeson nje siperfaqe prej 809,2 m2 me nje vlere neto me 31.12.2015 prej 972.939 leke.

Per efekte te evidences kontabel, sipas nje Raporti te zvogelimit te Kapitalit te Shoqerise me katin e pare dhe te trete te kesaj ndertese ne Qershor 2010, vlere fillestare e katit te dyte te-saj eshte 12.581.266 leke .

Shoqeria ne momentin e likuidimit, me 31.05.2017 zoteron vetem certifikaten e Magazines se ish Trikotazhit prej 546 m2. Shoqeria eshte ne ndjekje te sakesimit dhe marrjes se tyre me ZRPP Korce

Ne Bilancin e Shoqerise **SHA Kepuca Korce** te vitit 2010, ne raportin e drejtimit dhe ate te auditimit eshte pasqyruar mungesa e dy gabinave elektrike ( pjese ne grupin "Ndertesa") me nje vlere bruto 3.224.245 leke. Per kete mungese ne 28.01.2016, Keshilli mbikqyres ka vene ne ngarkim te ish-Administratores Zj.Diana Mekshi vleren neto te tyre prej 422.000 leke duke e kontabilizuar kete vlere ne zvogelim nga aktivet afatgjata dhe ngarkim te llogarise "debitore te tjere" sa shpjeguar me siper ne analizen e kesaj llogarie.

**Per Makineri e Paisje:**

Per zerin "Makineri per tu shitur si mbeturina", me vleren neto kontabel prej 869.399 leke perfaqeson nje grup mbetjesh nga makineri te ndryshme te Shoqerise **SHA Trikotazhi Korce**, gjate procesit te bashkimit, te cilat sugjerohen te vleresohen e te shiten si skrap.

**5. Huarat dhe parapagimet ne daten 31.05.2017 jane si vijon:**

<b>Detyrimet Afatshkurtra</b>	<b>31.05.2017</b>	<b>31.12.2016</b>	<b>Ndryshimi +/-</b>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	408,000.00		408,000.00
Te pagueshme ndaj punonjesve	264,175.00	135,580.00	128,595.00
Detyrime per Sigurime Shoq.Shend.	3,533,711.00	3,490,528.00	43,183.00
Detyrime tatimore per TAP-in	75,250.00	14,300.00	60,950.00
Detyrime tatimore per Tatimin ne Burim	187,883.00	145,883.00	42,000.00
Detyrime perGjoha e penalitete(gjyqi)	100,000.00	0.00	100,000.00
Debitore dhe Kreditore te tjere	958,015.00	958,015.00	0.00
Debitore dhe Kreditore te	747,732.00	450,232.00	297,500.00

EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

tjere(K.Mbikqyres)

Totali	6,274,766.00	5,194,538.00	1,080,228
--------	--------------	--------------	-----------

Lidhur me keto detyrime japim shpjegimet si vijon:

- Te pagueshme ndaj furnitoreve me nje vlere prej 408.000 leke perfaqesojne detyrimet ndaj Eksperteve Kontabel per auditimin e bilancit te vitit 2016 prej 108.000 leke dhe Ekspertit per certifikimin e Bilancit te Likuidimit prej 300.000 leke

- **Te pagueshme ndaj personelit dhe keshillit mbikqyres:**

Shoqeria ka rillogaritur te gjitha detyrimet e papaguara ndaj personelit dhe keshillit mbikqyres duke i saktësuar ato me 31.05.2017.

Shoqeria ka te punësuar 5 persona me kete strukture dhe keto paga bruto:

- Administrator, me page bruto	75.000 leke
- Ekonomiste	50.000
- Magazinier	37.500
- Roje	37.500
- Roje	37.500 leke

Ne zerin "Detyrime per paga" kane mbetur pa paguar total pagat e personelit per periudhen Maj 2017 me nje vlere neto 199.525 leke dhe paga e prillit e nje roje dhe nje magazinier prej 32.325 leke secili, pra me nje vlere total prej 264.175 leke.

Ndersa per keshillin mbikqyres detyrimet paraqiten me nje vlere prej 747.732 leke.

Keshilli mbikqyres perbehet nga tre vate si me poshte shenuar:

- Elvin Lako me nje pages bruto	30.000 leke
- Nevila Drishti	20.000
- Ardit Collaku	20.000 leke

Shoqeria ka llogaritur dhe raportuar tatimin ne burim qe i takon ketj grupi.

Sipas analizes qe ne i beme ketij zeri rezulton qe te jene te papaguar personat dhe periudhat si vijon:

Elvin Lako periudha Dhjetor 2016 deri Maj 2017 me nje vlere neto	153.000 leke
Nevila Drishti periudha Prill 2016 deri Maj 2017 me nje vlere neto	238.000 leke
Ardit Collaku periudha Dhjetor 2016 deri Maj 2017 me nje vlere neto	102.000 leke
Eslemvera Zake periudha Prill 2016 deri Gusht 2016	85.000 leke
Ish Administrator i Trikotazhit Korce Leonard	85.000 leke
<b>Total</b>	<b>663.000 leke</b>

Krahasuar keto detyrime analitike me vleren e pasqyruar ne Bilanc kane nje diference prej 84.732 leke me shume te cilat sugjerohen te rimeren ne te ardhura.

- **Detyrime tatimore**

**EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR**

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

Shoqeria **SHA Kepuca Korce** me 31.05.2017 per mungese fondesh ka te papaguara sigurimet shoqerore e shendetsore dhe TAP per te dyja Shoqerite pjesmarrese ne bashkim te cilat nga te dhenat on-line te sistemit tatimor, paraqiten si me poshte vijon:

Detyrimet ndaj tatimeve	Kodi Tatimor	<i>Kepuca Korce</i>	<i>Trikotazhi Korce</i>
		<u>31.07.2017</u>	<u>31.07.2017</u>
Tatim ne burim	kodi 1500	1,215,639.00	0.00
Tatim fitimi	kodi 1100	49,321.00	0.00
TAP	kodi 2200		517,785.00
Kontribute Prill Maj 2017/2015	kodi 1900	159,057.00	290,646.00
Kontribute 2005-2006/2005-2014	kodi 2100	96,852.00	2,194,725.00
<b>Totali</b>		<u><b>1,520,869.00</b></u>	<u><b>3,003,156.00</b></u>

Duhet theksuar se Shoqeria ke nje vlere prej 3.773.970 leke ne detyrimet e saj te Bilancit te Likuidimit me 31.05.2017, nderkohe qe detyrimet total te saj ne sistemin tatimor jane prej 4.524.025 leke (1.520.869+3.003.156).

Per rrjedhoje duhet rakorduar me sistemin e tatimeve dhe duhen vendosur detyrimet e sakta ne Bilancin e Likuidimit te Shoqerise.

Saktesojme se kjo periudhe perkon me zbatimin e Ligjit te faljes se gjobave per deklarime te vonuara apo detyrime te papaguara.

*Ne keto kushte Likuidatori i Shoqerise duhet te kryje procedurat per faljen e ketyre gjobave dhe duhet te kryje pagesat e detyrimeve per sigurimet shoqerore e shendetsore me qellim perftimin e faljes.*

Ne postin "Kreditore te tjere" eshte pasqyruar nje detyrim me nje vlere prej 958.015 leke, i krijuar ne momentin e bashkimit te te dy shoqerive, e cila perfaqesson kundervleren e makinerive-hekurishte te destinuara per tu shitur si skrap. Sugjerojme qe kjo vlere te meret ne te ardhura te Shoqerise, pasi nuk perfaqeson asnje lloj detyrimi.

**6. Detyrimet afatgjata**

Shoqeria **SHA Kepuca Korce** me 31.05.2017 ka ne postin e "Huave afatgjata" nje vlere prej 19.686.443. Ne Bilancin e Transformimit ne Shoqeria Anonime me kapital shteteror ne vitin 1998 kjo hua me emertimin "Fond Kunderparti" ka pasur nje vlere prej 18.351.265 leke. Shpjegimet qe i janc dhene ketij posti ne bilancet e mevonshme jane te ekzistences se nje kredie nga komuniteti europian per furnizimin e shojeve te kepuceve. Ne kushtet e mungeses se informacionit, sugjerojme Likuidatorin te kerkoje prane Qendres se Administrimit te Kredive Shteterore nese Shoqeria **SHA Kepuce Korce** ka ndonje detyrim ndaj ketij institucioni. Nese kjo vlere nuk perfaqeson asnje detyrim sugjerohet te meret ne te ardhurat e shoqerise.

**7. KAPITALI**





Kapitali i Shoqerise SHA Kepuce Korce paraqitet me 31.05.2017 si vijon:

		31.05.2017	31.12.2016	31.12.2015
<b>KAPITALI</b>		88,768,272	91,466,862	91,720,729
1	Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)			
2	Kapitali aksionereve te shoq.meme (PF te kons.)		0	
3	Kapitali aksionar	46,903,320	46,903,320	46,903,320
4	Rezerva e rivleresimit te tokes	57,720,728	57,720,728	57,720,728
5	Njesite ose aksionet e thesarit (Negative)			
6	Rezervat statutore	1,975,579	1,975,579	1,975,579
7	Rezervat ligjore	3,210,143	3,210,143	3,210,143
8	Rezervat e tjera	158,869	158,869	158,869
9	Fitimet e pa shperndara(humbje te viteve kaluara	-18,501,777	-18,247,910	-18,515,213
10	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	-2,698,590	-253,867	267,303

**8. Te Ardhurat dhe Shpenzimet 01.01.207 deri 31.05.2017**

Shoqeria gjate periudhes se mesiperme ka perftua nje fond prej 300.000 mije leke me te cilat ka mbuluar nevojat e saj me te domosdoshme, dhe periudha ka rezultuar me humbje. Gjithashtu eshte rimare ne te ardhura vlera e pakontabilizuar e nje vendroje prej 101.550 leke Shpenzimet jane si me poshte vijon:

Shpenzime paga e sigurime	1.242.855 leke
Keshilli Mbikqyres	350.000
Shpenzime per karburant	192.000
Shpenzime udhetimi	50.000
Shpenzime administrative	22.790
Personel jasht ndermarjes	408.000
Provigjon gjyqesor	100.000
Amortizim 5-mujor	718.510
Gjoha e te ngjashme	15.000
Te tjera financiare	985
-----	
Total shpenzimet	3.099.155 leke

Humbja e Shoqerise me 31.05.2017, ne momentin e shpalljes se likuidimit eshte 2.698.590 leke.

**Ne menyre te permbledhur sugjerime**

- Ne zerin Kliente shuma e pidentifikuar prej 681.880 leke sugjerohet te kaloje ne humbje te shoqerise.
- Ne zerin Kliente per shumen e identifikuar prej 2.100.000 leke sugjerohet pas njoftimeve ne QKB te kryeje procedurat per kalimin ne humbje.

Ludmilla PALUKA

License Nr 161, datë 25.01.2007

- Ne zerin "Debitorë të Tjere" shuma prej 667.776 leke e cila është e paidentifikuar sugjerohet të kalojë në humbje të Shoqërisë.
- Ne zerin "Debitorë të Tjere" shuma prej 789.014 leke, si e drejte e pretenduar në çështje gjyqësore e cila është humbur në dy shkalle, sugjerohet të provizionohet në humbje të Shoqërisë.
- Ne zerin "Debitorë të Tjere"- TVSH, shuma prej 10.000 leke nuk qëndron si e drejte e pretenduar referuar sistemit tatimor on-line, sugjerohet të kalojë në humbje.
- Ne zerin "Te drëjta ndaj Ortakëve" shuma prej 365.299 leke e cila nuk ka shpjegime përse kërkohet kjo e drejte ndaj Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, sugjerohet të kalojë në humbje.
- Ne zerin "Inventari" me një vlerë prej 8.618.141 leke, i cili është analitik në kontabilitetin e Shoqërisë sugjerohet të kryhen procedurat sipas Udhezimit Nr.30, datë 27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik".
- Ne zerin "Aktive Afatgjata" sugjerohet të kërkohet pranë ZRRPP Korce që pronat të cilat nuk kanë certifikate pronësie të paisen me to.
- Shoqëria Kepuca Korce, në bazë të kërkimeve ka edhe 16.5 m<sup>2</sup> truall me një Ndertese-Vend- Roje, nën emrin e Shoqërisë **SHA Kepuca Korce**.  
**Kjo prone u regjistrua në Kontabilitet me një vlerë 101.550.**
- Ne zerin "Detyrime Tatimore" të kryhen pagesat për detyrimet ndaj Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore si dhe kryerjen e procedurave për faljen e gjobave me synim të mos rëndohet situata e detyrimeve dhe pagesave të shoqërisë. Gjithashtu sugjerohet Likuidatori të rakordoje me Institutin e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetsore për detyrime të paraportuara dhe të papaguara me qëllim saktësimin e këtij zeri në Bilancin e Likuidimit.
- Ne zerin "Kreditorë të Tjere" me një vlerë prej 958.015 leke, kjo shumë nga menyra e kontabilizimit nuk përfaqëson asnjë detyrim, si e tillë sugjerohet të kalojë në të ardhura të Shoqërisë.
- Ne zerin "Kreditorë të Tjere" me një vlerë prej 747.732 leke e cila përfaqëson detyrimet ndaj anëtarëve të keshillit mbikqyres, analiza e këtij detyrimi përfaqëson vlerën prej 663.000 leke. Diferenca prej 84.732 leke, si vlerë e paidentifikuar të merret në të ardhura.
- Ne zerin "Huamarrje të tjera afatgjata" me një vlerë prej 19.686.443 leke, kjo shumë e paidentifikuar për gjatë historikut të Shoqërisë sugjerohet të merret në të ardhura të saj. Shoqëria e cila ka filluar procesin e Likuidimit, pas Njoftimeve për Kreditorët në portalin e QKB do të njohet me ndonjë pretendim të mundshëm lidhur me postet kreditorë të saj. e për rrjedhojë duhet të mbajë qëndrimin ligjor për ato poste kreditorë të cilat nuk janë të identifikuar.

**Pas analizës së hollesishme për çdo post të Bilancit në momentin e shpalljes së likuidimit me 31.05.2017 dhe sugjerimeve të dhëna e konsiderojmë misionin të kryer**

Eksperte Kontabel e Regjistruar  
Ludmilla PALUKA

Tirane me 17.07.2017

Licenca Nr 161, datë 25.01.2007  
Nr cel.0692036339

